



Die Gewerkschaft.

**Ti bashkëvendos!
Së bashku arrijmë më shumë!**

**Unë dua të di më shumë
për Unia.
Më kontaktoni ju lutem.**

Emri/Mbiemri

Nr. Telefon

Email

Unë kam edhe këtë propozim/kërkesë:

Ne punojmë për të jetuar

Me këtë anketë ne tash po e përgatisim ripërtëritjen e Kontratës së Përgjithshme të Punës në vitin e ardhshëm. Mirëpo, qysh këtë vjeshtë ne duhet të luftojmë së bashku për të arritur një rritje të denjë të pagave.

Në ndërtimtari nuk ka pasur dhe nuk ka krizë. Përkundrazi, dega e ndërtimtarisë qëndron shumë mirë.

Librat e porosive janë plot. Ju e bëni një punë jashtëzakonisht të madhe, gjithnjë e më pak punëtorë duhet të ndërtojnë gjithnjë e më shumë.

Megjithatë, nuk kishte gati asnjë ngritje të pagave viteve të fundit. Qiratë dhe sigurimet shëndetësore janë ngritur më shumë se pagat në vitet e fundit. Edhe kjo duhet të ndryshojë.

Ne do të mund të realizojmë kërkesat për një kontratë më të mirë apo për paga më të mira, vetëm nëse edhe ti merr pjesë:

- **Diskuto me kolegët e tu për përmirësimet e domosdoshm në Kontratën e Përgjithshme Kombëtare.**
- **Bisedoni edhe mes vete, se si mund t'i realizojmë më mirë së bashku kërkesat tona.**
- **Aktivizohu në Unia, sindikatën tënde të ndërtimtarisë. Së bashku arrijmë më shumë!**

Unia në afërsinë tuaj:

Aargau Bachstrasse 41, Postfach, 5001 Aarau T +41 84 833 30 03, aargau@unia.ch
Bern Monbijoustrasse 61, 3001 Bern T +41 31 385 22 22, bern@unia.ch
Berner Oberland Aarestrasse 40, 3601 Thun T+ 41 33 225 30 20, thun@unia.ch
Biel-Seeland / Solothurn Murtenstrasse 33, Postfach 1280, 2501 Biel T +41 32 329 33 33, biel-solothurn@unia.ch
Fribourg route des Arsenaux 15, 1705 Fribourg T +41 26 347 31 31, fribourg@unia.ch
Genève chemin Surinam 5, case postale 288, 1211 Genève 13 T +41 84 894 81 20, geneve@unia.ch
Neuchâtel avenue de la Gare 3, case postale, 2001 Neuchâtel T+41 32 729 30 29, neuchatel@unia.ch
Nordwestschweiz Rebgasse 1, Gewerkschaftshaus, 4005 Basel T +41 84 811 33 44, nordwestschweiz@unia.ch
Ostschweiz-Graubünden Lämmlisbrunnenstrasse 41, Postfach 647, 9000 St. Gallen T +41 84 875 07 51, ostschweiz-graubuenden@unia.ch
Ticino via Canonica 3, Casella postale 5650, 6901 Lugano T +41 91 910 50 70, ticino@unia.ch
Transjurane rue des Moulins 19, case postale 1042, 2800 Delémont T +41 84 842 16 00, transjurane@unia.ch
Valais rue de la Dent-Blanche 9, 1950 Sion T +41 27 322 60 48, valais@unia.ch
Wallis Bahnhofstrasse 4, Postfach 220, 3930 Visp T+41 27 984 12 80, oberwallis@unia.ch
Vaud place de la Riponne 4, Case postale 7667, 1002 Lausanne T +41 84 860 66 06, vaud@unia.ch
Zentralschweiz St. Karlstrasse 21, Postfach 4241, 6002 Luzern T +41 41 249 93 00, zentralschweiz@unia.ch
Zürich-Schaffhausen Stauffacherstrasse 60, Postfach 1544, 8026 Zürich T +41 44 296 18 18, zuerich-schaffhausen@unia.ch

Unia Zentralsekretariat
Weltpoststrasse 20
Postfach 272
3000 Bern 15
T +41 031 350 21 11
info@unia.ch
www.unia.ch



Die Gewerkschaft.
Le Syndicat.
Il Sindacato.

**Bashkëvendos!
Anketë për përtëritjen e KPK**

Mendimi yt është vendimtar

Kontrata e Përgjithshme Kombëtare (KPK) është kontratë e përgjithshme e punës për degën kryesore të ndërtimtarisë. Ajo rregullon kushtet e punës për të gjithë punëtorët e ndërtimtarisë në Zvicër. Vitin e ardhshëm, ne do të bisedojmë për një KPK të re.

Ndërtimtaria po ecën mirë. Ndërmarrjet kanë punë, ndërsa ndërtimtarët fitojnë para të mira. Punëtorët e ndërtimtarisë japin një kontribut të jashtëzakonshëm. Ju, punëtorët e ndërtimtarisë, krijoni fitimet, prandaj edhe duhet të përfitoni diçka nga kjo. Ju keni merituar kushte më të mira të punës!

Prandaj, sindikata Unia tani dëshiron të dijë nga ti, se cilat janë kërkesat tua kryesore. Çfarë duhet të përmirësohet në ndërtimtarinë? Për çfarë duhet të angazhohemi ne në bisedime? Për çfarë luftojmë ne së bashku? Ti mund t'i bësh tre kryqë (X), ose për tri kërkesa të ndryshme, ose dy X për një kërkesë, apo edhe tre X për një kërkesë, që për ty është më e rëndësishmja. Temat e mundshme janë të sqaruara shkurtë në faqet në vijim. Dhe ne do të pyesim, se sa i gatshëm je ti të luftosh së bashku me ne për kërkesat e tua dhe për një Kontratë të Përgjithshme Kombëtare. Sepse vetëm kështu ne mund të ecim përpara.

Të ndërpritet puna në mot të keq


Puna duhet të ndërpritet kur bën mot i keq:

- bazuar në kritere të qarta (temperatura, reshjet, shpejtësia e erës, ...)
- pa zbritje të të ardhurave, dhe
- pa vjedhje të orëve



Orar i rregulluar qartë

Orari i punës duhet të rregullohet qartë. Për shembull, gjatë tërë vitit 8 orë punë në ditë, ose së paku 7.5 orë në dimër dhe më së shumti 8.5 orë në verë.



Koha e udhëtimit është orar pune

Koha e udhëtimit prej depos deri në kantier dhe ngarkimi i sendeve të llogariten orar pune dhe duhet të paguhet.




Më shumë pushime dhe ditë të lira

Të drejtë për 3 javë pushime përnjëherë në verë dhe më shumë ditë të lira me pagesë.



Përvoja dhe shkollimi duhet të vlerësohen!

Pas tri vitesh përvojë profesionale duhet të pasojë një ndërrim nga kategoria e pagave C në B; Vozitësit e vinçit dhe Makinistët të marrin pagë më të lartë.



Kujdes zbritja e pagave!

Duhet ndërmarrë masa më efektive kundër zbritjes së pagave dhe puna e përkohshme (Temporer) duhet të kufizohet.



Shtesa më të larta

Kompensim më i madh për shujtën e drekës, shtesa më të larta për punën e natës e me ndërrime dhe për punën e tepërt.



Të luftojmë së bashku!

Ne do të mund ta arrijmë një Kontratë të Përgjithshme Kombëtare më të mirë, me mbrojtje më të mirë, nëse ne luftojmë së bashku. Për këtë na duhesh edhe ti.

Menidimi yt vendos

Në 7 kërkesat e mëposhtme ti mund t'i vendosësh më së shumti 7 kryqë (X). Ti mund t'i vendosësh kryqat në tri kërkesa, ose në dy kërkesa ose në një të vetme, që për ty janë më të rëndësishmet. Talonin e dorëzon në Sekretariatit e Unia.

Ti mund t'i vendosësh më së shumti tre kryqë!

	Të ndërpritet puna në mot të keq	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
	Orar i rregulluar qartë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
	Koha e udhëtimit është orar pune	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
	Më shumë pushime dhe ditë të lira	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
	Përvoja dhe shkollimi duhet të vlerësohen!	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
	Kujdes zbritja e pagave!	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
	Shtesa më të larta	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Të luftojmë së bashku!

Këtu mund të vësh kryq aty ku dëshiron ti.

Unë jam gati:

- të dal në rrugë jashtë orarit të punës për një KPK
- të luftoj në kantier gjatë orarit të punës, nëse ka nevojë edhe të bëj grevë

A ke propozime apo kërkesa për Unia? A duhet të kontaktojë Unia? Atëherë plotësoje anën tjetër!